

Relacion Teknik

Objekti:

Ndertim i kompleksit sportiv dhe rehabilitim i fushes se mbetjeve te ngurta

Të përgjithshme.

Qyteti i Pukës është qendra administrative e Bashkisë Pukë dhe e rrethit Pukë në tërësi. Ndodhet në lartësinë 830m mbi nivelin e detit, Bashkia Pukë ka një popullsi rreth 16.000 banorësh, ndërsa qyteti ka një popullsi prej 5600 banorësh, në qytet ndodhen 2 shkolla, një e mesme e përgjithshme dhe shkolla 9-vjeçare “Migjeni”. Bashkia në patronazhin e saj ka ekipin e futbollit “Terbuni” dhe një fushë futbollit në parametrat teknike kombëtare, stadiumi “Ismail Xhemali”, e cila përdoret për stërvitjen dhe ndeshjet e ekipit të “Terbunit”.



Fig. 1 Pamje e stadiumit «Ismail Xhemali» Pukë (parë nga sheshi i propozuar në projekt).

Në qytet ka hapsira të mjaftueshme për të krijuar fusha të tjera të reja sportive për argëtimin e rinisë dhe amatorëve sportdashës të lojrave me top. Mungesa e fushave sportive stafin drejtues të Bashkisë dhe të ekipit të “Terbunit” e ka vënë në pozita të vështira përballë kërkesave të qytetarëve për të lejuar përdorimin e fushës së vetme të futbollit, pasi ajo është nën mirëmbajtjen e vazhdueshme për të qenë në gadishmëri në përballjen e sfidave kombëtare që ka ekipi në futboll. Në

këto kushte Bashkia Pukë është angazhuar për të përmbushur kërkesat e rinisë qytetare duke bërë të mundur ndërtimin e dy fushave të reja (kompleks sportiv). Për ndërtimin e tyre është menduar nga Bashkia, kryesisht me nismën e kryetarit të saj z. Gjonaj Gjonaj, që me realizimin e një investimi të vetëm të bëhet e mundur edhe rehabilitimi i fushës së mbetjeve të ngurta urbane, e cila ndodhet në anën veriore të qytetit, mbas stadiumit të qytetit. Kjo fushë e përdorur ndër vite si vënddepozitim i mbjeteve të ngurta ndodhet e ekspozuar në natyrë pa ndonjë funksion të veçantë në shërbim të qytetarëve, përkundrazi përveç ekspozimit të mbetjeve në natyrë ajo ka shëmtuar këtë kënd piktoresk mes pyllit me gështenja dhe pisha të qytetit. Me ndërtimin e kompleksit sportiv, përveç plotësimit nevojave të rinisë qytetare për argëtim, krijohet një zonë kreative piktoreske mes pyllit me pemë të mëdha, plot hijeshi dhe freski.

Gjendja aktuale.

Fig. 1 Pamje e stendave të librit në bibliotekë.

Relievi i sheshit të propozuar për kompleksin sportive ka një terren relativisht të mirë dhe të përshtatshëm për fusha sportive në madhësinë e sipërfaqes së këkruar prej 1218m². Ajo është krijuar nga mbushja ndër vite me material të ngurta urbane, të cilat Bashkia Pukë i ka gruposur duke i mbuluar me dhe humusor gjatë gjithë kohës ndër vite, relieve duhet niveluar në kuotën që kërkon plani i ndërtimit të fushave nëpërmjet gërmimeve me makineri në sasi jo të mëdha, por niveluese. Sheshi nuk ka pemë por vetëm vegetacion bari, ky shesh kufizohet nga një pyllë me pemë shumë të mëdha pishash, gështjenjash, etj.



Fig. 2 Pamje e vënd depozitimit të mbetjeve të ngurta (propozuar për kompleks sportiv).

Kjo zonë e qytetit të Pukës është nga më të frekuentuarat nga qytetarët, të cilët e përdorin për

argëtim e pushim gjatë orarit të mbasdites, në kufi me sheshin e propozuar kalon një rrugë auto e ndërtuar së fundmi nga Bashkia, e cila lidh qytetin me një ndër fshatrat me shumë histori e tradita lokale e kombëtare, Kabashin.

Masat inxhinierike.

Duke parë nga afër gjëndjen e sheshit të propozuar për rehabilitimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe ndërtimin e kompleksit sportiv, konkludojmë ; që për ndërtimin e kompleksit sportiv duhet të realizohen punimet sipas planifikimit që vijon:



Fig. 3 pamje 3D e projektit të propozuar.

Punimet që janë parashikuar të zbatohen sipas këtij projekti përfshijnë:

1. Punime Germimi, Mbushje, Nivelimi.

| | | | |
|---|---|----|------|
| 1 | Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3 | 43,6 |
| 2 | Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak | m3 | 780 |

Këto punime përfshijnë detyrat që dalin për të bërë të mundur nivelimin e sheshit në parametrat e kompleksit sportiv, nëpërmjet gërmimit dhe mbushjes.

2. Punime Shtresash e Betoni.

| | | | |
|---|---|-----|-------|
| 1 | Shtrese stabilizanti t=5cm | m2 | 1216 |
| 2 | Shtrese betoni C 16/20 (t=15cm) | m3 | 182,4 |
| 3 | F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm (dopio zgare Ø 10/25cm) | ton | 6,0 |

| | | | |
|---|--|----|-----|
| 4 | Struktura monolite betoni C 16/20 (Kuneta) | m3 | 4,0 |
|---|--|----|-----|

Këto punime bëjnë të mundur ndërtimin e shtresës së betonit, mbi sipërfaqen e niveluar të sheshit të propozuar.

3. Punime Rrethimi.

| | | | |
|---|--|----|------|
| 1 | Rrethim me rrjete teli gabion (për fushë sportive, ngjyrë jeshile) | m2 | 516 |
| 2 | F.V. Shtylla metalike me profil katror 10x10cm te vendosur çdo 2m | kg | 1290 |

Gjatesia perimetrale e fushës e cila do të rrethohet me rrjete është 140.3m, ndërsa lartësia e parashikuar e rrethimit h=3.65m.

Rrjeta që do të përdoret për rrethim do të jetë e standartit që kërkojnë fushat sportive. Rrjeta do të instalohet në shtylla metalike me profil katror 100x100x3 të vendosur çdo 3,5m aksiale.

4. Punime Ndrëçimi. Sipas përcaktimeve të mëposhtme sasiore.

| | | | |
|---|--|------|---|
| 1 | FV ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250Ë GG FAE 44004, me llampe 250Ë 230V | cope | 8 |
| 2 | F V shtylla metalike per ndrëçim, H=7m, d=160mm | cope | 6 |
| 3 | FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10 | cope | 4 |
| 4 | F V krah dy degesh per shtylla metalike per ndrëçim | cope | 2 |
| 5 | F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm | cope | 6 |

Ndrëçimi do të realizohet nëpërmjet ndricuesave smart të instaluar në shtylla metalike xingato me lartësi nga toka 7m, të cilat do të vëndosen në cdo diagobale të fushave, në kufirin e dy fushave janë parashikuar që nëpërmjet 2 shtyllave me krah dy degësh të instalohen 4 ndricuesat. Ndrëçimi do të shërbejë për aktivitetet në orët e vona të mbrëmjes.

5. Punime Gjelberimi. Sipas përcaktimeve të mëposhtme sasiore.

| | | | |
|---|--|------|------|
| 1 | Transport dheu me auto deri 3.0 km | m3 | 180 |
| 2 | Stola druri me kons. metalik te thjeshte | cope | 8 |
| 3 | Mbjellje Bari | m2 | 1200 |
| 4 | F.V. Fidane Peme Dekorative | cope | 30 |

Sipërfaqia përreth kompleksit sportiv, e cila edhe pas nivelimit është e ekspozuar nga mbetjet e ngurta do të trajtohen me dhe' humosor për të qenë e gatshme dhe produktive në mbjelljen dhe rritjen e barit, për pushuesit do të vëndosen edhe stola të gjatë druri me konstruksion metalik, të fiksuara në tokë.

6. Punimet ne fusha. Sipas përcaktimeve të mëposhtme sasiore.

| | | | |
|---|--|------|--------|
| 1 | Tabela Basketbolli komplet (tabele + kosh + kons. metalik) | cope | 4 |
| 2 | Vijezim shirita gjatesor e anesor, gjeresi 12 cm, Akrelike | ml | 586,31 |
| 3 | Paralele Hekuri | cope | 4 |

Kompleksi sportiv do të plotësohet me aksesorët e lartshënuar si, tabela basketbolli, paralele, si dhe me vijëzimin e fushëve me bojë akrelike.

PUNOI:
ING. LAVDRIM BRUKA